



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA RAJONALE _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FARMACI _____

Nr. Prot., Datë

Nr. Prot., Datë

K O N T R A T Ë

“PËR RIMBURSIMIN E FARMACISË PËR RECETËN ELEKTRONIKE”

Ndërmjet

DREJTORISË RAJONALE TË FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR _____

Dhe

FARMACISË _____

Miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ të Fondit Nr. , datë

Kjo Kontratë nënshkruhet në _____, në datë _____

ndërmjet:

Drejtoria Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, (në vijim “DRF”) /Degës së Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, (në vijim DF”) _____ përfaqësuar nga Z/Znj. _____, Drejtor i DRF /DF _____, me llogari bankare nr. _____ pranë bankës _____ me adresë elektronike _____;

dhe

Farmacisë _____ (në vijim “Farmacia”), me të dhënat e mëposhtme:

Kodi i identifikimit nga Fondi _____,

Liçencë të Qendrës Kombëtare të Biznesit (në vijim QKB) nr. _____,

Nr. llogarie bankare _____ në bankën _____,

NIPT/NUIS nr. _____,

Adresa e Farmacisë _____

nr. telefoni _____ adresa elektronike _____,

Person fizik/ortak i vetëm/administrator/përfaqësues ligjor, Z/Znj. _____

me drejtues teknik Z/Znj. _____ me çertifikatë të Urdhrit të Farmacistëve Nr. _____.

Dispozita paraprake

Duke qenë se:

A. Drejtoritë Rajonale janë organe në varësi të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (në vijim “Fondi”), të cilat e zhvillojnë aktivitetin në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

B. Në bazë të ligjit të sipërcituar Fondi lidh kontrata me dhënësit e shërbimit shëndetësor për dhënien e shërbimeve shëndetësore të përfshira në paketat e shërbimeve ku bën pjesë Lista e Barnave të Rimbursuara dhe Lista e Pajisjeve Mjekësore të Rimbursuara (fisha diabeti), të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

C. “Farmaci” është njësi shëndetësore - tregtare ku kryhet furnizimi, ruajtja, përgatitja, ambalazhimi, paketimi, kontrolli, dhënia e barit dhe informacionit për përdorimin e tij, si dhe shërbime të tjera të kujdesit shëndetësor, në bazë të Ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”; i ndryshuar.

D. Farmacia përmbush kriteret për lidhjen e kontratave të miratuara nga Këshilli Administrativ i Fondit me VKA Nr. 71, datë 22.12.2015;

E. Këshilli Administrativ i Fondit ka miratuar kontratën tip, “Për rimbursimin e farmacisë për recetën elektronike”, me VKA nr. , datë;

F. Kushtet e kësaj kontrate janë në vazhdimësi të marrëdhënieve të mëparshme sipas kontratave të lidhur mes Fondit dhe Farmacisë, që nga viti _____ ;

palët e mësipërme bien dakord si vijon:

Neni 1 Objekti i kontratës

Realizimin e skemës së sigurimit shëndetësor nga Fondi, nëpërmjet rimbursimit të pjesshëm ose të plotë të çmimeve të barnave dhe pajisjeve mjekësore (fisha diabeti), që përdorin të siguarit, nëpërmjet rimbursimit të recetave të ekzekutuara në farmaci.

Neni 2 Baza ligjore

Për hartimin dhe zbatimin e kësaj kontrate palët i referohen dhe mbështeten mbi bazën ligjore që vijon:

1. Ligji Nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 05.03.2014, “Për miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”, i ndryshuar;
3. Ligji Nr. 105/2014, datë 31.07.2014 “Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik”, i ndryshuar;

4. Ligji Nr. 7975, datë 20.7.1995, “Për Barnat Narkotike dhe Lëndët Psikotrope”, i ndryshuar;
5. Ligji Nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil”, i ndryshuar;
6. Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për Kundërvajtjet Administrative”;
7. Ligji Nr. 9150, datë 30.10.2003, “Për “Urdhërin e Farmacistëve”, i ndryshuar;
8. Ligji Nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për Liçencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
9. Ligji Nr. 10107, datë 30.03.2009, “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
10. Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar;
11. Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, i ndryshuar;
12. Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar;
13. Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
14. Ligji Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar;
15. Ligji nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;
16. Ligj nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar;
17. Ligji nr.10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”;
18. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 144, datë 11.02.2009, “Për miratimin e formularëve të vetëdeklarimit, për të ushtruar veprimtarinë e tregëtimit me shumicë të barnave, të tregëtimit në farmaci dhe agjenci farmaceutike, si dhe të import - eksportit të tyre”;
19. Vendimi i Këshillit Administrativ Nr.34, datë 12.12.2019, “Për miratimin e rregullores mbi procedurat e përshkrimit, gjenerimit, ekzekutimit, kontrollit dhe rimbursimit të recetës elektronike e-Rx”;
20. Vendimi i Këshillit Administrativ Nr. 71, datë 22.12.2015, “Për kriteret që duhet të plotësojnë farmacitë dhe agjencitë farmaceutike për lidhjen e kontratës me Fondin dhe procedurat për lidhjen e kontratës”, i ndryshuar;
21. Vendimi Këshillit të Ministrave nr, datë, “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre”;
22. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 61, datë 03.02.2017, “Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme”, i ndryshuar.
23. Udhëzimi nr. 16, datë 03.04.2020, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.
24. Udhëzimi nr. 20, datë 01.06.2020, “Për elementët bazë dhe teknike, lëshimin dhe shkëmbimin e faturave elektronike dhe faturave shoqëruese”.
25. Vendimi i Këshillit Administrativ nr. 101, datë 22.10.2014, për miratimin e rregullores nr. 3, datë 22.10.2014, “Për procedurën dhe mënyrën e kontrollit të dhënësve të shërbimit të kontraktuara me Fondin”;
26. Urdhër 501, datë 03.07.2018, “Për miratimin e listës së barnave që tregëtohen pa recetë mjekësore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3 **Kriteret që duhet të përmbushë Farmacia**

Për lidhjen e kontratave me Fondin farmacia duhet të plotësojë këto kriteret:

1. Farmacia të jetë e licencuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
2. Drejtuesi teknik të jetë pajisur me çertifikatën përkatëse të Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë.
3. Farmacia të jetë e regjistruar pranë organeve tatimore dhe QKB.
4. Farmacia të ketë llogari bankare.
5. Farmacia që lidh kontratë për herë të parë ose pas një periudhe ndërprerje të ketë gjendje jo me pak se 60% të barnave alternativa të para-të listës së barnave, që rimbursohen në sasi të tillë jo më pak se sa mjekimi mujor sipas protokollit të përdorimit.
6. Drejtuesi teknik i Farmacisë të drejtojë vetëm farmacinë për të cilën është licencuar.
7. Farmacia të plotësojë kushtet për ruajtjen dhe tregëtimin e barnave, standardet frigoriferike për ruajtjen dhe tregëtimin e barnave termolabile, kondicionimin e ajrit, si dhe të jetë pajisur me termometër për matjen e temperaturës së ambientit.
8. Farmacia të jetë e pajisur me kasafortë për ruajtjen e barnave narkotike dhe helmet e tabelës II. (Kur ajo është e licencuar t'i tregëtojë ato).
9. Farmacia të jetë e pajisur me kompjuter për të realizuar kompjuterizimin e të dhënave, sipas programeve të përgatitura nga Fondi dhe standardeve të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.
10. Farmacistët e punësuar, të jenë të pajisur me leje të vlefshme të ushtrimit të profesionit nga Urdhëri i Farmacistëve të Shqipërisë.
11. Farmacistët dhe nd/farmacistët e punësuar, të kenë kontratë punësimi me personin juridik/fizik ortakun e vetëm/administratorin/përfaqësuesin ligjor.
12. Nuk lidhet kontratë me Agjencitë Farmaceutike në qytetet dhe fshatrat ku ka Farmaci me kontratë.
13. Nuk lidhet kontratë me personin juridik/fizik ortakun e vetëm/administratorin/përfaqësuesin ligjor apo drejtues teknik të Farmacisë, i cili:
 - është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë
 - është në ndjekje penale dhe ndaj të cilit është marrë masa e sigurimit personal për vepra penale që lidhen me legjislacionin e barnave dhe me këtë kontratë.
14. Farmacia të ketë të vendosur në pjesën e jashtme të saj në mënyrë të dukshme, emrin tregëtar me të cilin është regjistruar pranë QKB-së.
15. Farmacia që lidh kontratë me Fondin, duhet të ketë hyrjen e saj në një distancë të paktën 20 m nga kufiri i jashtëm i Institucionit Shëndetësor publik.
16. Nuk lidhet kontratë me Farmacinë nëse:
 - a. në mjediset e Farmacisë ushtrohet aktivitet tjetër privat ose familjar, jo farmaceutik.

- b. mjediset e Farmacisë nuk janë të ndara nga ambientet e tjera private ose familjare.
- c. Për Farmacitë që lidhin kontratë për herë të parë (veç sa më lart, pikat 1-16):
- d. Farmacia që lidh kontratë për herë të parë duhet të ketë sipërfaqe të shfrytëzueshme mbi 50 m². (genplan i lëshuar nga arkitekt/inxhinier i liçencuar);
- e. Farmacia që lidh kontratë për herë të parë, duhet të jetë në një distancë të tillë jo më pak se 150 m (rrugë këmbësore) nga farmacia ekzistuese me kontratë (plan vendosje dhe vërtetim lëshuar nga arkitekt/inxhinier i liçencuar).
- f. Farmacia që lidh kontratë për herë të parë, duhet të ketë hyrjen e saj në një distancë të paktën 20 m nga kufiri i jashtëm i Institucionit Shëndetësor publik.

Neni 4 Performanca dhe dokumentacioni

1. Farmacia për periudhën që është e kontraktuar me Drejtorinë Rajonale, duhet të vendosë në hyrje të saj:
 - a. emrin e saj tregëtar i cili duhet të jetë i njëjtë me atë të regjistruar në QKB;
 - b. posterin: “Farmaci me Kontratë me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore” të furnizuar nga Drejtoria Rajonale;
 - c. orarin dhe çdo informacion të shpërndarë nga Fondi për realizimin e skemës së sigurimeve shëndetësore. Në rast të ndërprerjes së kontratës, Farmacia duhet të heqë posterin e mësipërm. Në rastin kur refuzohet heqja e posterit, njoftohen organet përkatëse për ndjekjen e procedurave konform ligjit.
2. Farmacia të mbajë në ambientin ku punon listën e barnave që rimbursohen dhe listën e pajisjeve mjekësore (fisha diabeti) , nga Fondi dhe ta vërë atë në dispozicion të pacientëve, sa herë që i kërkohet. Kjo listë barnash dhe listë pajisjesh mjekësore (fisha diabeti) duhet ti vihet në dispozicion farmacisë nga Drejtoria Rajonale, në mënyrë shkresore ose elektronike (me email).
3. Farmacia është e detyruar të mbajë në ambientet e saj, dokumentet origjinale ose fotokopje të noterizuara të këtyre dokumenteve:
 - a. liçenca e ushtrimit të aktivitetit/QKB;
 - b. regjistrimit tatimor NIPT/NUIS;
 - c. kontratat e punësimit të personelit teknik farmaceutik;
 - d. çertifikatat e anëtarësimit në Urdhërin e Farmacistëve (të personelit teknik farmaceutik të punësuar).
4. Farmacia duhet të ketë llogari në programin e-Rx dhe farmacisti të jetë i pajisur me nënshkrim elektronik. Drejtoria Rajonale trajnon të gjithë përdoruesit e sistemit e-RX për përdorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit.
5. Farmacia gjatë veprimtarisë së saj është e detyruar të respektojë detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave për pacientët, në përputhje me kriteret e përpunimit të këtyre të dhënave sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
6. Farmacia pranon pranë ambienteve të saj, studentët e farmacisë që të kryejnë praktikën mësimore dhe profesionale, kundrejt dokumentit përkatës nga universitetet dhe UFSH.

Neni 5

Ndryshimet në të dhënat ose aktivitetin e Farmacisë

1. Kur Farmacia, në ndryshim nga orari i afishuar, ndërpret aktivitetin për më shumë se një ditë (pune) duhet të lajmërojë me shkrim ose në mënyrë elektronike, Drejtorinë Rajonale për kohën e ndërprerjes; për këtë periudhë ajo nuk rimbursohet.
2. Në rastin e ndryshimit të licencës së QKB, të NIPT-it/NUIS, të personit fizik/ortak i vetëm/administrator/përfaqësues ligjor, të drejtuesit teknik, të farmacistëve të punësuar dhe të adresës së saj, Farmacia duhet të njoftojë me shkrim Drejtorinë Rajonale brenda 5 ditëve pune. Për ndryshimet e mësipërme plotësohet formulari i Përditësimit të Vetëdeklarimit.
3. Në rastin e ndryshimit të personit juridik/fizik/ortak i vetëm/administrator/përfaqësues ligjor apo drejtuesit teknik i Farmacisë, Farmacia ushtron aktivitetin brenda afatit të kontratës së mëparshme dhe personi juridik/fizik /ortaku i vetëm/administratori/ përfaqësuesi ligjor i ri mbart në vazhdimësi të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kjo kontratë deri në përfundim të saj.

Neni 6

Drejtuesi teknik i Farmacisë

1. Drejtues teknik i farmacisë është çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë ose i huaj, që plotëson kërkesat e mëposhtme:
 - a) zotëron diplomë universitare të Fakultetit të Farmacisë; për shtetasit e huaj nevojitet njësimi i diplomës universitare nga autoriteti përgjegjës;
 - b) ka një përvojë pune prej tre vjetësh në farmaci;
 - c) është anëtar i Urdhrit të Farmacistëve;
 - ç) drejtuesi teknik i farmacisë e ushtron këtë rol vetëm për një farmaci.
2. Farmacia lejohet ta ushtrojë veprimtarinë vetëm në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar.
3. Drejtuesi teknik i farmacisë është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë teknike dhe profesionale që zhvillohet në farmaci.

Neni 7

Administrimi i dokumentacionit teknik të Farmacisë

1. Në funksion të zbatimit të kësaj kontrate, do të konsiderohet dokumentacion teknik i farmacisë këto dokumenta:
 - a) fletë daljet e Importuesve/Shpërndarësve farmaceutikë (hyrje në farmaci dhe kthim barnash)
 - b) recetat me rimbursim sipas programit e-Rx dhe receta pa rimbursim;
 - c) listë treguesit;

2. Dokumentacioni i mësipërm duhet të ketë formën dhe të jetë plotësuar siç paraqitet në Aneksin Nr.1, “Dokumentacioni teknik i Farmacisë” të kësaj kontrate.
3. Dokumentacioni i farmacisë duhet të qëndrojë në farmaci, gjatë kontrollit të ushtruar nga Drejtoria Rajonale, dokumentacioni i munguar duhet të rikthehet në farmaci brenda 24 orëve dhe në rastet kur dokumentacioni është marrë për shqyrtim nga ndonjë institucion tjetër, duhet të paraqitet procesverbali i marrjes së këtij dokumentacioni.
4. Farmacia është e detyruar të ruajë dokumentacionin e mësipërm për një periudhë kohore sipas legjislacionit në fuqi dhe t’i verë në çdo kohë në dispozicion të Drejtorisë Rajonale për qëllime kontrolli dhe për kryerjen e inventareve. Farmacia të japë informacionet që i kërkon Drejtoria Rajonale dhe Fondi.

Neni 8

Administrimi dhe ekzekutimi i recetës me rimbursim

1. Farmacia tregton barnat e Listës së Barnave dhe pajisjet mjekesore (fisha diabeti) te listes që rimburohen vetëm kundrejt recetës së mjekut, me përjashtim të barnave OTC (barna që jepen pa recetën e mjekut) sipas listës së miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në vijim MSHMS). Farmacisë i rimburohen barnat dhe pajisjet mjekesore (fisha diabeti) që tregtohen vetëm nga importuesi/hperndares që kanë kontratë me Fondin.
2. Farmacia, ekzekuton recetat me rimbursim të gjeneruara dhe të nënshkruara elektronikisht nga mjeku vetëm kur pacienti paraqet kodin identifikues të recetës elektronike të lëshuar nga mjeku, si dhe dokumentin e identifikimit.
3. Farmacia të ekzekutojë recetat duke ndjekur saktësisht udhëzimet e Fondit lidhur me ekzekutimin e recetës elektronike.
4. Nuk do të rimburohen recetat të cilat nuk përmbushin rregullat mëposhtme:
 - a) Përshkrimi i barnave sipas emërimit xhenerik (përjashtuar veteranët dhe invalidët e luftës);
 - b) Respektimi i numrit të barnave në recetën me rimbursim të pjesshëm dhe Kategoria Pensionist (jo më shumë se tre barna);
 - c) Lëshimi i recetës së veçantë për barnat narkotike dhe psikotrope.
5. Farmacia të pranojë dhe ekzekutojë receta me rimbursim:
 - a) brenda tre ditëve recetat me antibiotikë;
 - b) brenda shtatë ditëve nga data e lëshimit, recetat e tjera me rimbursim.
6. Farmacia në të gjitha llojet e recetave me rimbursim që do të ekzekutojë, nuk duhet që sasia e barnave mjekim mbajtëse të kalojë kohën prej dy muaj, me përjashtim të rasteve të miratuara nga Fondi / Drejtoria Rajonale (por jo më shumë se 6 muaj).
7. Farmacia të ekzekutojë recetat me rimbursim të plotë për aq barna sa përshkruhen për diagnozë, recetat me rimbursim të pjesshëm deri në tre barna për diagnozë, për kategorinë pensionistë deri në tre barna për diagnozë.
8. Farmacisë i rimburohet vetëm bari:
 - a) i firmave farmaceutike prodhuese të përcaktuara në listën e barnave që rimburohen, me përjashtim të rasteve të invalidëve të luftës dhe veteranëve me sëmundje kronike;

- b) i pajisur me pullën e kontrollit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
 - c) i tregtuar vetëm nga Importuesi/Shpërndarësi Farmaceutik, që ka kontratë me Fondin.
9. Rimbursimi do të bëhet në masën e parashikuar për barin si alternativë e parë, përcaktuar si referencë në listën e barnave që rimbursohen.
 10. Farmacia do të ekzekutojë vetëm recetat e gjeneruara nga mjeku i familjes i të njëjtës ndarje territoriale që mbulon drejtoria përkatëse. Ekzekutimi i recetave jashtë këtij territori bëhet vetëm me miratim nga Drejtoria Rajonale.
 11. Farmacia është e detyruar t'i japë pacientit barnat e përshkruara në recetë pa bërë asnjë lloj zëvendësimi të formë-dozës, të principit aktiv apo të sasisë së barit të përshkruar nga mjeku.
 12. Farmacia është e detyruar të shkarkojë nga sistemi e-Rx barnat e LBR-së në fuqi, që jepen me recetë pa rimbursim ndërmjet opsioneve që ofron sistemi e-Rx (shkarkim malli/shitje me para në dorë/kthim malli/korigjim sasie).

Neni 9

Çmimet e tregtimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore (fisha diabeti)

1. Farmacia të zbatojë rigorozisht çmimet e shitjes së barnave dhe pajisjeve mjekësore (fisha diabeti), sipas listës së barnave dhe listes së pajisjeve mjekësore (fisha diabeti), në fuqi si dhe reflektimin e ndryshimeve të saj dhe të kërkojë rimbursim nga Drejtoria Rajonale për barnat dhe pajisjet mjekësore (fishat e diabetit) te listës.
2. Farmacia të kërkojë nga pacientët dokumentin e identifikimit (kartë identifikimi, pasaportë ose kartë shëndeti) dhe kodin identifikues të recetës.

Neni 10

Ekzekutimi i recetave të invalidëve të luftës dhe veteranëve dhe personave të diagnostikuar me Sars-Cov2

1. Në rastet kur bari i përshkruar në recetat e invalidëve të luftës, veteranëve me sëmundje kronike ose Personave të Diagnostikuar pozitiv me Sars-Cov2 (Covid 19) me sëmundje akute nuk është në listën e barnave që rimbursohen, pas ekzekutimit në sistemin e-Rx, farmacia paraqet fotokopjen e faturës origjinale e vulosur nga farmacia (ku bari i dhënë shënohet me shenjë – x) që i bashkëlidhet recetës së kësaj kategorie.
2. Në rast se receta përmban alternativat më të shtrenjta të barnave të listës së barnave që rimbursohen, Farmacia do të rimbursohet vetëm kur në recetë është plotësuar nga mjeku emri tregëtar i barit, duke plotësuar saktësisht kodin përkatës. Në rastin kur nuk është plotësuar emri tregëtar i barit, Farmacisë i rimbursohet bari në masën e alternativës së parë, sipas listës së barnave që rimbursohen.

Neni 11

Kontrolli nga Drejtoria Rajonale /Fondi

1. Farmacia është e detyruar të pranojë kontrollin me inventarizim dhe tematik për barnat e Listës së Barnave dhe pajisjeve mjekesore (fisha diabeti), te listes që rimbursohen, që bën Drejtoria Rajonale ose Fondi. Inventarizimi i barnave dhe pajisjeve mjekesore (fisha diabeti), kryhet veçmas sipas alternativave të firmave prodhuese brenda së njëjtës formë doze alternative të barit dhe pajisjeve mjekesore (fisha diabeti), ndërsa rezultati i kontrollit me inventar nxirret i përbashkët sipas alternativave të ndryshme të firmave prodhuese.
2. Kontrolli dhe inventarizimi bëhet në prezencë të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar, sipas rregullores të miratuar nga Fondi, të cilët u bëhen të njohur farmacive.
3. Akt rakordimi përfundimtar bëhet vetëm në prezencë të drejtuesit teknik të farmacisë dhe/ose të personit fizik/ortak i vetëm/administrator/përfaqësues ligjor i farmacisë.
4. Farmacia është e detyruar të pranojë kontrollin me inventarizim për barnat e rimbursueshme dhe pajisjet mjekesore (fisha diabeti), te rimbursueshme në rastet e ndërprerjes së kontratës. Nga kontrolli i ushtruar farmacia është e detyruar të pranojë sanksionet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate.
5. Farmacia gjatë kontrollit duhet të paraqesë dokumentacionin e saj të parashikuar në këtë kontratë sa herë që i kërkohet nga specialistët e kontrollit të Drejtorisë Rajonale /Fondit. Kur ky dokumentacion kërkohet për verifikim merret nga Farmacia me procesverbal nga grupi i kontrollit dhe pas verifikimit, dorëzohet përsëri në Farmaci me procesverbal brenda 15 ditëve.
6. Farmacia kontrollohet me inventarizim për Barnat e Listës dhe pajisjet mjekesore (fisha diabeti) nga DRF, përfshirë dhe kontrollin për periudhat e mëparshme, por jo më shumë se 2 (dy) herë në 12 muaj.
7. Grupi i kontrollit i Drejtorisë Rajonale apo FONDIT, duhet të përbëhet jo më pak se nga 2 (dy) anëtarë, ku të paktën njëri të jetë farmacist, të pajisur me fletë identifikimi dhe urdhër kontrolli. Në rast të kundërt grupi i kontrollit nuk pranohet nga Farmacia për kontroll.
8. Drejtoria Rajonale përpara çdo kontrolli njeh dhe pranon deklaratën me shkrim të Farmacisë për ndryshime të mundshme të qarkullimit të barnave dhe pajisjet mjekesore (fisha diabeti) të dokumentacionit.
9. Drejtoria Rajonale në kontrollin me inventar, inventarizon jo më pak se 50 barna me konsum dhe vlerë më të lartë rimbursimi.
10. Drejtoria Rajonale është e detyruar të ushtrojë kontroll me inventarizim, në farmaci, për të gjithë barnat e Listës së Barnave dhe pajisjeve mjekesore (fisha diabeti), që rimbursohen, në rastin e zgjidhjes së kontratës. Deri në daljen e rezulttit përfundimtar, Farmacisë nuk i rimbursohen recetat që ajo ka të depozituara/dorëzuara në Drejtorinë Rajonale.

Neni 12

Kontrolli për periudhat e mëparshme

1. Farmacia kontrollohet nga Drejtoria Rajonale /Fondi për periudhën e mëparshme të kontraktuar bazuar në detyrimet dhe sanksionet që i përkasin asaj periudhe. Kontrolli do të kryhet vetëm për periudhën pas kontrollit të fundit me inventar, ndërsa për barnat e rimbursueshme të cilat nuk janë kontrolluar në kontrollin e fundit me inventar, merret si periudhë e fundit inventari i dorëzuar me hyrjen në fuqi të listës së barnave që rimbursohen për atë periudhë.
2. Farmacisë ti vihet në dispozicion një urdhër pagesë mbi detyrimin e përfituar padrejtësisht. Për mospagim të detyrimit brenda afatit të përcaktuar, Farmacisë do t'i zbritet nga rimbursimi vlera përkatëse e përfituar padrejtësisht, pavarësisht nga arsyet dhe nga koha në të cilën konstatohet kjo diferencë.

Neni 13

Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave

1. Farmacia duhet të dorëzojë në Drejtorinë Rajonale dy herë në muaj:
 - a) listë treguesit analitik të recetave me rimbursim;
 - b) listë treguesin përmbledhës;
 - c) pasqyrën përmbledhëse të faturave hyrje – dalje.
2. Dokumentat sipas pikave a, b dhe c, printohen në dy kopje nga programi e-Rx, firmosen, vulosen dhe dorëzohen në datën _____, për periudhën nga data 16 deri në fund të muajit paraardhës dhe datën _____, për periudhën nga data 1 deri më 15 të çdo muaji, por jo më vonë se tre ditë pune pas datave të caktuara.
3. Në raste të forcave madhore bëhet shtyrja me marrëveshje për pranimin e dosjes për rimbursimin e recetave elektronike në afatin e pranuar mes palëve. Një kopje e dokumentave dorëzohet në Drejtorinë Rajonale, tjetra mbahet nga Farmacia.
4. Numri serial i recetave të rimbursueshme është unik dhe gjenerohet automatikisht nga sistemi.
5. Farmacia duhet të regjistrojë në programin e-Rx:
 - a) të dhënat lidhur me recetat me rimbursim, në momentin e ekzekutimit;
 - b) të dhënat për faturat hyrje - dalje të barnave të rimbursueshme dhe pajisjeve mjekesore (fisha diabeti), brenda 5 ditëve pune nga data e ekzekutimit.
6. Farmacia duhet të dorëzojë (vetëdeklarojë) inventarin e gjendjes fizike të barnave dhe pajisjeve mjekesore (fisha diabeti), të listës që rimbursohen, të regjistruar në programin e-Rx, të printuar, të firmosur dhe vulosur në çdo fletë, si më poshtë:
 - a) Kur lidh kontratë për herë të parë ;
 - b) kur lidh kontratë pas një periudhe ndërprerje;
 - c) kur hyn në fuqi Lista e re e Barnave dhe pajisjeve mjekesore (fisha diabeti), të rimbursueshme (gjendjen fizike të barnave dhe pajisjeve mjekesore (fisha diabeti), të rimbursueshme si dhe të barnave dhe pajisjeve mjekesore (fisha diabeti), që kanë dalë nga lista), brenda 15 ditëve, nga hyrja në fuqi e Listës;
 - d) në çdo rast tjetër kur kërkohet nga Drejtoria Rajonale, duke përcaktuar datën dhe kohën e printimit të inventarit.

Neni 14

Krijimi i aksesit në programet dhe dokumentacionin e sigurimeve shëndetësore

DRF duhet të pajisë Farmacinë me Listën e Barnave dhe listen e pajisjeve mjekesore (fisha diabeti), që rimbursohen, të cilat u vihen në dispozicion me email, me listën e Importuesve/Shpërndarësve farmaceutikë të barnave, si dhe me listen e Importuesve të pajisjeve mjekesore (fisha diabeti) që kanë kontratë me FONDIN/Drejtorinë Rajonale, si dhe me aktet nenligjore të sigurimeve shëndetësore që lidhen me veprimtarinë e Farmacisë. Këto informacione dhe të tjera, janë vënë në dispozicion në mënyrë elektronike, edhe në faqen zyrtare të internetit të Fondit.ëëë. fsdksh.gov.al

Neni 15

Pranimi i dosjes për rimbursim nga DRF

1. Drejtorisë Rajonale merr në dorëzim nga drejtuesi teknik i farmacisë ose farmacisti i punësuar, dosjen për rimbursimin e recetave elektronike , e cila përmban:
 - a) Listë treguesin analitik të recetave me rimbursim në 2 kopje;
 - b) Proces - verbalin e listëtreguesit në 2 kopje;
 - c) Listëtreguesin e faturave në 2 kopje
2. DRF harton proces - verbalin e pranimit në 2 kopje, pranon si dhe konfirmon pranimin e recetave të periudhës në programin e-Rx.
3. Farmacia është e detyruar të paraqesë pranë Drejtorisë Rajonale dokumentacionin përkatës konform vendimeve/udhëzimeve të organeve tatimore.

Neni 16

Rimbursimi i Farmacisë

1. Drejtorja Rajonale njofton drejtuesin teknik të farmacisë, për detyrimin përfundimtar të njohur për rimbursim nga Fondi dhe i dorëzon :
 - a) kopjen e akt - rakordimit përfundimtar;
 - b) listën e recetave që nuk janë pranuar për rimbursim.
2. Drejtorja Rajonale bën xhirimin e shumës vetëm pas paraqitjes nga ana e Farmacisë të dokumentacionit përkatës konform vendimeve/udhëzimeve të organeve tatimore me vlerën e njohur si detyrim nga akt-rakordimi.

Neni 17

Komunikimi mes palëve

1. Komunikimi ndërmjet FONDIT/Drejtorisë Rajonale dhe Farmacive për të gjitha çështjet që përshkruhen dhe rrjedhin nga kjo kontratë të jetë në formë elektronike, shkresore dhe e konfirmuar nga palët.
2. Drejtorja Rajonale organizon takime të përbashkëta periodike me farmacistët ose me përfaqësuesit e tyre të njohur nga organet kompetente, për sqarimin e problemeve të

lindura gjatë zbatimit të kontratës dhe udhëzimeve të ndryshme të nxjerra nga FONDI. Konkluzionet e dala protokollohen dhe u përcillen zyrtarisht farmacive.

3. Të gjitha llojet e procesverbaleve, marrëveshjeve etj., bëhen në dy kopje, nga të cilat njëra i jepet Farmacisë dhe tjetra i mbetet Drejtorisë Rajonale/FONDIT.
4. Drejtoria Rajonale duhet të njoftojë farmacinë zyrtarisht për të gjitha masat e mara ndaj Farmacisë si dhe për zgjidhjen e kontratës, brenda 3 ditëve pune nga dita e marrjes së vendimit.
5. Drejtoria Rajonale gjatë veprimtarisë së saj është e detyruar të respektojë detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave në përputhje me kriteret e përpunimit të këtyre të dhënave, sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
6. Për çdo shkelje nga ana e Drejtorisë Rajonale të detyrimeve të saj dhe fshehjes së rezultateve fiktive nga Drejtoria Rajonale, Drejtori i Përgjithshëm i Fondit përcakton përgjegjësitë dhe merr masë administrative deri në kallzim penal ndaj personave përgjegjës. Për sa më sipër njoftohet Farmacia.

Neni 18

Pranimi dhe verifikimi i inventarëve në bazë vetëdeklarimi

1. Drejtoria Rajonale pranon nga Farmacia inventare të printuar sipas formatit të programit informatik të FONDIT (të vulosur e firmosur) pa korrigjime. Në të kundërt, inventarët nuk pranohen.
2. DRF verifikon saktësinë e inventarit të dorëzuar nga Farmacia në rastet kur:
 - a) farmacia lidh kontratë për herë të parë;
 - b) farmacia rilidh kontratë pas një periudhe ndërprerje nga ana e Drejtorisë Rajonale /Fondit.

Neni 19

Gjobat

1. Për çdo shkelje nga ana e Farmacisë të detyrimeve të saj të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 4, “Performanca dhe dokumentacioni”, Farmacia gjobitet në masën 10 000 lekë.
2. Për çdo shkelje nga ana e Farmacisë të detyrimeve të saj të parashikuara në pikën 1, të nenit 5, “Ndryshimi në të dhënat ose aktivitetin e farmacisë”, Farmacia gjobitet në masën 50 000 lekë.
3. Për çdonjërin nga shkeljet nga ana e Farmacisë të detyrimeve të saj të parashikuara në pikën 1, 2 dhe 3 të nenit 13, “Dorëzimi dhe Regjistrimi i të dhënave”, Farmacia gjobitet në masën 5 000 lekë, si edhe për vonesa të dorëzimit të recetave dhe listë treguesve përtej afatit 7 ditë (nga data e dorëzimit) Farmacia gjobitet në masën 10,000 lekë.
4. Për shkelje nga ana e Farmacisë, të pikës 6, të nenit 13, “Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave”, për vonesë në regjistrimin online në programin e Fond-it, të inventarit të gjendjes fizike të barnave të listës së barnave që rimbursohen (inventarin në momentin e lidhjes së kontratës si dhe atë të hyrjes në fuqi të listës së barnave që rimbursohen), DRF vendos gjobë në masën 2,000 lekë.

5. Për shkelje nga ana e Farmacisë, të pikës 5, shkronja b), neni 13, “Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave”, për vonesë në regjistrimin e të dhënave hyrje - dalje online pas afatit të 5 ditëve pune, në programin e Fond-it, Drejtoria Rajonale vendos gjobë në masën 2,000 lekë për çdo faturë hyrje ose dalje.
6. Për shkelje nga ana e Farmacisë, të pikës 6, shkronja b), të nenit 13, “Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave”, për vonesë tej afatit të dorëzimit (vetëdeklarimit) të inventarit në formë të printuar, Drejtoria Rajonale vendos gjobë në masën 20,000 lekë.
7. Për zgjidhje të kontratës nga ana e farmacisë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 24, Farmacia gjobitet në masën 200,000 lekë dhe i nështrohet kontrollit me inventar nga Drejtoria Rajonale.
8. Kur nga kontrolli i ushtruar rezulton se në Farmaci nuk gjendet drejtuesi teknik ose farmacisti i punësuar, por gjendet farmacist pa kontratë punësimi me subjektin (vetëm për herë të parë), Farmacia paguan gjobë në masën 50,000 lekë.
9. Për mos deklaram të çdonjërit nga detyrimet e pikës 2, të nenit 5, “Ndryshimet në të dhënat ose aktivitetin e Farmacisë“, pas afatit kohor të përcaktuar Farmacia paguan gjobë në masën e 20,000 lekëve.
10. Për mosvënien në dispozicion të grupit të kontrollit, brenda 24 orëve, të çdonjërit nga dokumentacionet e pikës 1, të nenit 8, “Administrimi i dokumentacionit teknik të Farmacisë”, Farmacia paguan gjobë prej 10,000 lekë.
11. Kur nga kontrolli i ushtruar konstatohet se në mjediset e Farmacisë mbahen barna të LBR dhe pajisjeve mjeksore (fisha diabeti) të skaduara (të pa veçuar dhe të pashoqeruara me etiketën përkatëse me mbishkrimin të skaduara/jashtë përdorimit,) Farmacia paguan kusht penal në masën 10,000 lekë për çdo kuti të konstatuar.
12. Në çdo rast, të kontrolleve mbi deklaramet e të dhënave në sistemet e Fondit, dhe kur konstatohet se, subjekti farmaceutik (Farmacia) nuk ka pranuar një faturë, ndërkohë që kjo faturë është leshuar nga Importuesi apo Shpërndarësi, atëherë subjekti farmaceutik (Farmacia) do të paguajë gjobë në vlerën prej 2 000 lekë për çdo faturë.
13. Procedura e konstatimit, vendosjes dhe ekzekutimit të gjobës bëhet në përputhje me ligjin, “Për kundravajtjet administrative”.

Neni 20

Ndalimi nga rimbursimi

1. Kur nga kontrolli me inventar i ushtruar në farmaci gjatë periudhës që kjo kontratë është në fuqi rezultojnë diferenca në plus (gjendja fizike e barnave të listës dhe pajisjeve mjeksore (fisha diabeti) është më e madhe se gjendja kontabël) për të cilën është rimbursuar, Farmacia është e detyruar të kthejë dyfishin e shumës së konstatuar si diferencë në plus. Kjo shumë, i zbritet Farmacisë nga vlera e rimbursimit të muajve pasardhës.
2. Kur nga kontrolli me inventar i ushtruar në farmaci gjatë periudhës që kjo kontratë është në fuqi rezultojnë diferenca në minus (gjendja fizike e barnave të listës është më e vogël se gjendja kontabël), Farmacia është e detyruar të paguajë dyfishin e shumës së konstatuar si diferencë në minus.

3. Farmacisë nuk do t'i rimbursohen recetat për çdo shkelje të pikave 2, 3, 4, 5, 8 të nenit 8, "Administrimi dhe ekzekutimi i recetës me rimbursim" si dhe të pikës 1, të nenit 10, "Ekzekutimi i recetave të invalidëve të luftës dhe veteranëve dhe personave të diagnostikuar me Sars-Cov2".

Neni 21 Pezullim aktiviteti

1. Në rastet kur ndaj personit juridik/fizik/ortakun e vetëm/administratorin/përfaqësuesin ligjor të Farmacisë administratorit dhe/ose përfaqësuesit ligjor të subjektit farmaceutik fillon procedim penal, nga organi i akuzës për çështje që lidhen me pikat e kësaj kontrate, farmacisë i pezullohet aktiviteti kontraktual, deri në përfundimin e plotë të hetimeve. Për këtë periudhë farmacia nuk duhet të ekzekutojë receta me rimbursim pasi nuk i rimbursohet vlera e këtyre recetave.

Neni 22 Zgjidhja e kontratës dhe moslidhja e saj për një afat të caktuar

1. Në Farmaci gjendet faturë fiktive ose recetë fiktive e gjeneruar nga sistemi e-Rx, të cilat vërtetohen, asaj i zgjidhet kontrata për një periudhë 5 vjeçare nga dita e njoftimit zyrtar për këtë zgjidhje, për këtë rast bëhet kallëzim penal.
2. Nga kontrolli në Farmaci, gjendet duke shërbyer person që nuk është farmacist, farmacisë i zgjidhet kontrata dhe nuk i rilidhet për një periudhë 5 vjeçare nga dita e njoftimit zyrtar për këtë zgjidhje.
3. Farmacia nuk pranon për kontroll ose shmang kontrollin, pa arsye të paraqitura me shkrim, të specialistëve të Drejtorisë Rajonale ose të FONDI-t, të cilët janë të pajisur me fletë identifikimi dhe urdhër kontrolli, asaj i zgjidhet kontrata për një periudhë 1 vjeçare nga dita e njoftimit zyrtar për këtë zgjidhje.
4. Nga kontrolli në Farmaci, në mungesë të drejtuesit apo të farmacistit të punësuar, gjendet duke shërbyer person i pa pajisur me certifikatën e anëtarësimit të Urdhërit të Farmacistëve, farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë 1 vjeçare nga dita e njoftimit zyrtar për këtë zgjidhje.
5. Për vonesë një mujore të pargumentuar nga afati i përcaktuar, i dërgimit të të dhënave nga ana e Farmacisë, sipas pikës 5, të nenit 13, "Dorëzimi dhe Regjistrimi i të Dhënave", Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë kohore jo më pak se 1 vit nga koha e zgjidhjes.
6. Në rastet kur vërtetohet se Farmacia ekzekuton ose ka ekzekutuar receta me barna të rimbursueshme përtej afatit të tyre të vlefshmërisë (skadencës), Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë kohore jo më pak se 1 vit nga koha e zgjidhjes.
7. Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë 1 vjeçare nga dita e njoftimit për këtë zgjidhje kur nga kontrolli në Farmaci konstatohet se:
 - a. në ambientet e saj ushtrohet aktivitet tjetër privat ose familjar, jo farmaceutik;

- b. ambientet e saj komunikojnë direkt (qoftë të ndarë edhe me derë) me ambiente të tjera private ose familjare;
8. Nga kontrollat me inventarizim të ushtruar në farmaci gjatë periudhës që kjo kontratë është në fuqi rezultojnë diferenca në plus, të cilat në totalin e tyre e kalojnë vlerën mbi 150,000 lekë, Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë 1 vjeçare nga koha e zgjidhjes.

Neni 23 **Ndërprerja e kontratës**

1. Nga kontrolli në Farmaci (rast i përsëritur) nuk gjendet drejtuesi teknik apo farmacisti i punësuar me kontratë dhe i deklaruar pranë Fondit, por farmacist i pakontraktuar, ndërpritet kontrata nga data e njoftimit zyrtar të saj deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se 6 muaj që nga koha e ndërprerjes.
2. Nga kontrolli në Farmaci nuk gjendet drejtuesi teknik apo farmacisti i lartë i punësuar por ndihmës farmacisti i punësuar, ndërpritet kontrata nga data e njoftimit zyrtar të saj, deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore që nga koha e ndërprerjes.
3. Në rastet kur vërtetohet se Farmacia ka ekzekutuar recetën duke bërë ndryshimin (konvertimin) e formë - dozës apo principit aktiv të barit të përshkruar në recetë nga mjeku, Farmacisë i ndërpritet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore që nga koha e ndërprerjes.
4. Kur nga kontrolli rezulton se Farmacia tregton barna të Listës së Barnave që rimburohen të pa pajisur me pullën e kontrollit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM-së), Farmacisë i ndërpritet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore që nga koha e ndërprerjes dhe i propozohet institucionit përkatës për heqjen e licencës.
5. Në rastin e recetave me rimbursim të kategorive Veteranë dhe Invalidë lufte, nëse pas verifikimit të recetave vërtetohet se Farmacia nuk ka dhënë barin e përshkruar në recetë nga mjeku por një alternativë më të lirë pa pasqyruar saktë kodin e barit të dhënë, Farmacisë i ndërpritet kontrata për një periudhë jo më pak se për një periudhë 6 mujore nga koha e ndërprerjes.
6. Për deklaram të rremë, Farmacisë i ndërpritet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se një periudhë 6 mujore nga koha e ndërprerjes.
7. Në rastet kur vërtetohet se Farmacia ka ekzekutuar recetën duke i dhënë pacientit barna dhe pajisje mjeksore (fisha diabeti) më pak në sasi ose lloj, se ato të përshkruara në recetë nga mjeku, Farmacisë i ndërpritet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore nga koha e ndërprerjes .
8. Nëse në akt rakordimin përfundimtar të kontrollit me inventar, mungon pa arsye, drejtuesi teknik dhe/ose personi juridik/fizik/ortaku i vetëm/administratori/përfaqësuesi ligjor, Farmacisë i ndërpritet kontrata për një periudhë 6 mujore nga koha e ndërprerjes.

9. Për vonesën, një muaj nga data e caktuar e dorëzimit të recetave dhe listë treguesve të tyre, Farmacisë i ndërpritet kontrata për një periudhë 6 muajore nga koha e ndërprerjes. Përfshihen rastet e vonesave për shkak të forcave madhore.
10. Ndryshimi i secilit prej kriterëve gjatë periudhës që kjo kontratë është në fuqi, përbën shkak për ndërprerjen e kontratës.
11. Në çdo rast tjetër që sanksionohet me ligj.

Neni 24

Procedura e zgjidhjes së kontratës

1. Te dyja palët mund të zgjidhin kontratën duke njoftuar zyrtarisht me shkrim, palën tjetër mbi arsyet e zgjidhjes së kontratës.
2. Drejtoria Rajonale është e detyruar të bëjë likuidimin e Farmacisë sipas procedurës së përshkruar në këtë kontratë deri në datën kur është marrë njoftim nga ana e Farmacisë për zgjidhjen e kontratës.
3. Drejtoria Rajonale do të rimbursojë Farmacinë për periudhën e ankimimit administrativ deri në ditën kur Farmacia është njohur me vendimin ose përgjigjen për ankimin, nga Fondi.
4. Drejtoria Rajonale, në rastet e zgjidhjes së kontratës, heq nga subjekti posterin me mbishkrimin “Farmaci me Kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”.

Neni 25

Pasojat e zgjidhjes së kontratës

1. Me zgjidhjen e kontratës dhe mbarimin e afatit të ankimit administrativ, Farmacisë nuk i rimbursohen më recetat.
2. Në rastin e zgjidhjes së kontratës nga ana e farmacisë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 24, Farmacisë nuk i rimbursohet vlera e recetave që ajo ka të depozituara në Drejtorinë Rajonale. Në këtë rast Farmacia nuk mund të rilidhë kontratën më shpejt se një periudhë kohore 1 vjeçare nga koha e zgjidhjes së kontratës.
3. Në rast të mbarimit të afatit të kontratës dhe mos aplikimit për rilidhje në vazhdimësi farmacia nuk gëzon të drejtën e lidhjes së kontratës për një periudhë 1 vjeçare, me përjashtim të rasteve kur Farmacia ka njoftuar Drejtorinë Rajonale mbi arsyet e vonesës në lidhjen e kontratës.
4. Administrator/përfaqësues ligjor i subjektit farmaceutik të cilit i është zgjidhur kontrata sipas nenit 22, nuk mund të lidhë kontratë të re me Fondin me një subjekt tjetër farmaceutik deri në përfundim të penalitetit të subjektit farmaceutik të cilit i është zgjidhur kontrata.

Neni 26 **Ankimi Administrativ**

1. Subjekti ose personi përgjegjës ndaj të cilit është vendosur një sanksion sipas parashikimeve të kësaj kontrate, ka të drejtën e ankimit pranë Komitetit të Shqyrtimit Administrativ të Fondit, brenda 30 ditëve nga marrja në dijeni e vendimit me sanksionin përkatës.
2. Ankimi administrative duhet të përmbajë këto elemente:
 - a. subjektin që ushtron ankimin me të dhënat identifikuese dhe adresën e tij;
 - b. procedurën konkrete për të cilën paraqitet ankimi;
 - c. një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar dhe bazën ligjore përkatëse;
 - d. pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar;
 - e. provat dhe dokumentacionin përkatës të cilat kërkohen të shqyrtohen nga Komiteti.
3. Komiteti i Shqyrtimit Administrativ shqyrton brenda 30 ditëve ankimin e paraqitur në përputhje me kërkesat e pikës 2 të këtij neni, por jo më vonë se afati i përfundimit të procedurës administrative.
4. Ankimi administrativ i paraqitur në përputhje me kërkesat e këtij neni, pezullon ekzekutimin e vendimit deri në vënien në dijeni të ankuesit me vendimin e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ.
5. Kundër vendimit të Komitetit subjekti mund të ankohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Neni 27 **Ndryshimet e kontratës**

1. Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me shkrim dhe me vullnetin, dhe pëlqimin e të dyja palëve.
2. Çdo ndryshim, shtesë ose shfuqizim i plotë ose i pjesshëm i kësaj kontrate nuk do të ketë fuqi nëse nuk është kryer me shkrim dhe nënshkruar nga të dyja palët kontraktuese/përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve.

Neni 28 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Palët kontraktuese respektojnë legjislacionin shqiptar në fuqi dhe përpiqen që mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë realizimit të kontratës, t'i zgjidhin me mirëkuptim midis tyre.
2. Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër duke bërë një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.
3. Palët kontraktuese të përfshira në mosmarrëveshje duhet të bëjnë personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mbi parimin e ruajtjes së vazhdimësisë së punës.
4. Nëse palët kontraktuese apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit

apo për një kohë më të gjatë të miratuar nga palët, njëra palë njofton palën tjetër se çështja nuk është zgjidhur.

5. Për të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, ku ushtron aktivitetin.
6. Në rastet kur gjykata vendos masa paraprake deri në marrjen e vendimit të formës së prerë, palët duhet të zbatojnë të drejtat dhe detyrimet e kontratës objekt gjykimi.

Neni 29

Afati i kontrates dhe hyrja në fuqi

1. Kjo kontratë lidhet me afat deri në hyrjen në fuqi të LBR dhe LPMR së re. Ky afat mund të ndryshojë me miratimin e përbashkët me shkrim të palëve.
2. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i shtrin efektet e saj nga data _____.
3. Kjo kontratë është përpiluar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe secila nga palët mban nga 1 (një) kopje.
4. Kontrata pasi u lexua nga palët, u konsiderua e redaktuar sipas pëlqimit të tyre dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur.

Kjo kontratë firmoset nga:

Për DREJTORINË RAJONALE TË FONDIT _____ /DEGA E FONDIT

..... Emri, Mbiemri dhe firma e Drejtorit të DRF/DF

Për Farmacinë _____

..... Emri, Mbiemri dhe firma e Personit fizik/ortak i
vetëm/administrator/përfaqësues ligjor

..... Emri, Mbiemri dhe firma e drejtuesit teknik

ANEKSI 1

Neni 1

Gjobat

14. Për çdo shkelje nga ana e Farmacisë të detyrimeve të saj të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 4, “Performanca dhe dokumentacioni”, Farmacia gjobitet në masën 10 000 lekë.
15. Për çdo shkelje nga ana e Farmacisë të detyrimeve të saj të parashikuara në pikën 1, të nenit 5, “Ndryshimi në të dhënat ose aktivitetin e farmacisë”, Farmacia gjobitet në masën 50 000 lekë.
16. Për çdonjëren nga shkeljet nga ana e Farmacisë të detyrimeve të saj të parashikuara në pikën 1, 2 dhe 3 të nenit 13, “Dorëzimi dhe Regjistrimi i të dhënave”, Farmacia gjobitet në masën 5 000 lekë, si edhe për vonesa të dorëzimit të recetave dhe listë treguesve përtej afatit 7 ditë (nga data e dorëzimit) Farmacia gjobitet në masën 10,000 lekë.
17. Për shkelje nga ana e Farmacisë, të pikës 6, të nenit 13, “Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave”, për vonesë në regjistrimin online në programin e Fond-it, të inventarit të gjendjes fizike të barnave të listës së barnave që rimbursohen (inventarin në momentin e lidhjes së kontratës si dhe atë të hyrjes në fuqi të listës së barnave që rimbursohen), DRF vendos gjobë në masën 2,000 lekë.
18. Për shkelje nga ana e Farmacisë, të pikës 5, shkronja b), neni 13, “Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave”, për vonesë në regjistrimin e të dhënave hyrje - dalje online pas afatit të 5 ditëve pune, në programin e Fond-it, Drejtoria Rajonale vendos gjobë në masën 2,000 lekë për çdo faturë hyrje ose dalje.
19. Për shkelje nga ana e Farmacisë, të pikës 6, shkronja b), të nenit 13, “Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave”, për vonesë tej afatit të dorëzimit (vetëdeklarimit) të inventarit në formë të printuar, Drejtoria Rajonale vendos gjobë në masën 20,000 lekë.
20. Për zgjidhje të kontratës nga ana e farmacisë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 24, Farmacia gjobitet në masën 200,000 lekë dhe i nështrohet kontrollit me inventar nga Drejtoria Rajonale.
21. Kur nga kontrolli i ushtruar rezulton se në Farmaci nuk gjendet drejtuesi teknik ose farmacisti i punësuar, por gjendet farmacist pa kontratë punësimi me subjektin (vetëm për herë të parë), Farmacia paguan gjobë në masën 50,000 lekë.
22. Për mos deklaram të çdonjërit nga detyrimet e pikës 2, të nenit 5, “Ndryshimet në të dhënat ose aktivitetin e Farmacisë“, pas afatit kohor të përcaktuar Farmacia paguan gjobë në masën e 20,000 lekëve.
23. Për mosvënien në dispozicion të grupit të kontrollit, brenda 24 orëve, të çdonjërit nga dokumentacionet e pikës 1, të nenit 8, “Administrimi i dokumentacionit teknik të Farmacisë”, Farmacia paguan gjobë prej 10,000 lekë.
24. Kur nga kontrolli i ushtruar konstatohet se në mjediset e Farmacisë mbahen barna të LBR dhe pajisjeve mjeksore (fisha diabeti) te skaduara (të pa veçuara dhe te pashoqeruara me etiketën përkatëse me mbishkrimin të skaduara/jashtë përdorimit,) Farmacia paguan kusht penal në masën 10,000 lekë për çdo kuti të konstatuar.

25. Në çdo rast, të kontrollove mbi deklaratimet e të dhënave në sistemet e Fondit, dhe kur konstatohet se, subjekti farmaceutik (Farmacia) nuk ka pranuar një faturë, ndërkohë që kjo faturë është leshuar nga Importuesi apo Shpërndarësi, atëherë subjekti farmaceutik (Farmacia) do të paguajë gjobë në vlerën prej 2 000 lekë për çdo faturë.
26. Procedura e konstatimit, vendosjes dhe ekzekutimit të gjobës bëhet në përputhje me ligjin, “Për kundravajtjet administrative”.

Neni 2

Ndalimi nga rimbursimi

4. Kur nga kontrolli me inventar i ushtruar në farmaci gjatë periudhës që kjo kontratë është në fuqi rezultojnë diferenca në plus (gjendja fizike e barnave të listës dhe pajisjeve mjeksore (fisha diabeti) është më e madhe se gjendja kontabël) për të cilën është rimbursuar, Farmacia është e detyruar të kthejë dyfishin e shumës se konstatuar si diferencë në plus. Kjo shumë, i zbritet Farmacisë nga vlera e rimbursimit të muajve pasardhës.
5. Kur nga kontrolli me inventar i ushtruar në farmaci gjatë periudhës që kjo kontratë është në fuqi rezultojnë diferenca në minus (gjendja fizike e barnave të listës është më e vogël se gjendja kontabël), Farmacia është e detyruar të paguajë dyfishin e shumës se konstatuar si diferencë në minus.
6. Farmacisë nuk do t'i rimbursohen recetat për çdo shkelje të pikave 2, 3, 4, 5, 8 të nenit 8, “Administrimi dhe ekzekutimi i recetës me rimbursim” si dhe të pikës 1, të nenit 10, “Ekzekutimi i recetave të invalidëve të luftës dhe veteranëve dhe personave të diagnostikuar me Sars-Cov2”.

Neni 3

Pezullim aktiviteti

2. Në rastet kur ndaj personit juridik/fizik/ortakun e vetëm/administratorin/përfaqësuesin ligjor të Farmacisë administratorit dhe/ose përfaqësuesit ligjor të subjektit farmaceutik fillon procedim penal, nga organi i akuzës për çështje që lidhen me pikat e kësaj kontrate, farmacisë i pezullohet aktiviteti kontraktual, deri në përfundimin e plotë të hetimeve. Për këtë periudhë farmacia nuk duhet të ekzekutojë receta me rimbursim pasi nuk i rimbursohet vlera e këtyre recetave.

Neni 4

Zgjidhja e kontratës dhe moslidhja e saj për një afat të caktuar

9. Në Farmaci gjendet faturë fiktive ose recetë fiktive e gjeneruar nga sistemi e-Rx, të cilat vërtetohen, asaj i zgjidhet kontrata për një periudhë 5 vjeçare nga dita e njoftimit zyrtar për këtë zgjidhje, për këtë rast bëhet kallëzim penal.

10. Nga kontrolli në Farmaci, gjendet duke shërbyer person që nuk është farmacist, farmacisë i zgjidhet kontrata dhe nuk i rilidhet për një periudhë 5 vjeçare nga dita e njoftimit zyrtar për këtë zgjidhje.
11. Farmacia nuk pranon për kontroll ose shmang kontrollin, pa arsye të paraqitura me shkrim, të specialistëve të Drejtorisë Rajonale ose të FONDI-t, të cilët janë të pajisur me fletë identifikimi dhe urdhër kontrolli, asaj i zgjidhet kontrata për një periudhë 1 vjeçare nga dita e njoftimit zyrtar për këtë zgjidhje.
12. Nga kontrolli në Farmaci, në mungesë të drejtuesit apo të farmacistit të punësuar, gjendet duke shërbyer person i pa pajisur me çertifikatën e anëtarësimit të Urdhërit të Farmacistëve, farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë 1 vjeçare nga dita e njoftimit zyrtar për këtë zgjidhje.
13. Për vonesë një mujore te pargumentuar nga afati i përcaktuar, i dërgimit të të dhënave nga ana e Farmacisë, sipas pikës 5, të nenit 13, “Dorëzimi dhe Regjistrimi i të Dhënave”, Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë kohore jo më pak se 1 vit nga koha e zgjidhjes.
14. Në rastet kur vërtetohet se Farmacia ekzekuton ose ka ekzekutuar receta me barna të rimbursueshme përtej afatit të tyre të vlefshmërisë (skadencës), Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë kohore jo më pak se 1 vit nga koha e zgjidhjes.
15. Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë 1 vjeçare nga dita e njoftimit për këtë zgjidhje kur nga kontrolli në Farmaci konstatohet se:
 - a. në ambientet e saj ushtrohet aktivitet tjetër privat ose familjar, jo farmaceutik;
 - b. ambientet e saj komunikojnë direkt (qoftë të ndarë edhe me derë) me ambiente të tjera private ose familjare;
16. Nga kontrollet me inventarizim të ushtruar në farmaci gjatë periudhës që kjo kontratë është në fuqi rezultojnë diferenca në plus, të cilat në totalin e tyre e kalojnë vlerën mbi 150,000 lekë, Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë 1 vjeçare nga koha e zgjidhjes.

Neni 5 Ndërprerja e kontratës

12. Nga kontrolli në Farmaci (rast i përsëritur) nuk gjendet drejtuesi teknik apo farmacisti i punësuar me kontratë dhe i deklaruar pranë Fondit, por farmacist i pakontraktuar, ndërpritet kontrata nga data e njoftimit zyrtar të saj deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se 6 muaj që nga koha e ndërprerjes.
13. Nga kontrolli në Farmaci nuk gjendet drejtuesi teknik apo farmacisti i lartë i punësuar por ndihmës farmacisti i punësuar, ndërpritet kontrata nga data e njoftimit zyrtar të saj, deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore që nga koha e ndërprerjes.
14. Në rastet kur vërtetohet se Farmacia ka ekzekutuar recetën duke bërë ndryshimin (konvertimin) e formë - dozës apo principit aktiv të barit të përshkruar në recetë nga mjeku, Farmacisë i ndërpritet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore që nga koha e ndërprerjes.
15. Kur nga kontrolli rezulton se Farmacia tregton barna të Listës së Barnave që rimburohen të pa pajisur me pullën e kontrollit të Agjencisë Kombëtare të Barnave

- dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM-së), Farmacisë i ndërpritet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore që nga koha e ndërprerjes dhe i propozohet institucionit përkatës për heqjen e liçencës.
16. Në rastin e recetave me rimbursim të kategorive Veteranë dhe Invalidë lufte, nëse pas verifikimit të recetave vërtetohet se Farmacia nuk ka dhënë barin e përshkruar në recetë nga mjeku por një alternativë më të lirë pa pasqyruar saktë kodin e barit të dhënë, Farmacisë i ndërpritet kontrata për një periudhë jo më pak se për një periudhë 6 mujore nga koha e ndërprerjes.
 17. Për deklaram të rremë, Farmacisë i ndërpritet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se një periudhë 6 mujore nga koha e ndërprerjes.
 18. Në rastet kur vërtetohet se Farmacia ka ekzekutuar recetën duke i dhënë pacientit barna dhe pajisje mjeksore (fisha diabeti) më pak në sasi ose lloj, se ato të përshkuara në recetë nga mjeku, Farmacisë i ndërpritet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore nga koha e ndërprerjes .
 19. Nëse në akt rakordimin përfundimtar të kontrollit me inventar, mungon pa arsye, drejtuesi teknik dhe/ose personi juridik/fizik/ortaku i vetëm/administratori/përfaqësuesi ligjor, Farmacisë i ndërpritet kontrata për një periudhë 6 mujore nga koha e ndërprerjes.
 20. Për vonesën, një muaj nga data e caktuar e dorëzimit të recetave dhe listë treguesve të tyre, Farmacisë i ndërpritet kontrata për një periudhë 6 mujore nga koha e ndërprerjes. Përfshihen rastet e vonesave për shkak të forcave madhore.
 21. Ndryshimi i secilit prej kriterëve gjatë periudhës që kjo kontratë është në fuqi, përbën shkak për ndërprerjen e kontratës.
 22. Në çdo rast tjetër që sanksionohet me ligj.

Neni 6

Procedura e zgjidhjes së kontratës

5. Te dyja palët mund të zgjidhin kontratën duke njoftuar zyrtarisht me shkrim, palën tjetër mbi arsyet e zgjidhjes së kontratës.
6. Drejtoria Rajonale është e detyruar të bëjë likuidimin e Farmacisë sipas procedurës së përshkruar në këtë kontratë deri në datën kur është marrë njoftim nga ana e Farmacisë për zgjidhjen e kontratës.
7. Drejtoria Rajonale do të rimbursojë Farmacinë për periudhën e ankimimit administrativ deri në ditën kur Farmacia është njohur me vendimin ose përgjigjen për ankimin, nga Fondi.
8. Drejtoria Rajonale, në rastet e zgjidhjes së kontratës, heq nga subjekti posterin me mbishkrimin “Farmaci me Kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”.

Neni 7

Pasojat e zgjidhjes së kontratës

5. Me zgjidhjen e kontratës dhe mbarimin e afatit të ankimit administrativ, Farmacisë nuk i rimburohen më recetat.
6. Në rastin e zgjidhjes së kontratës nga ana e farmacisë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 24, Farmacisë nuk i rimburohet vlera e recetave që ajo ka të depozituara në Drejtorinë Rajonale. Në këtë rast Farmacia nuk mund të rilidhë kontratën më shpejt se një periudhë kohore 1 vjeçare nga koha e zgjidhjes së kontratës.
7. Në rast të mbarimit të afatit të kontratës dhe mos aplikimit për rilidhje në vazhdimësi farmacia nuk gëzon të drejtën e lidhjes së kontratës për një periudhë 1 vjeçare, me përjashtim të rasteve kur Farmacia ka njoftuar Drejtorinë Rajonale mbi arsyet e vonesës në lidhjen e kontratës.
8. Administrator/përfaqësues ligjor i subjektit farmaceutik të cilit i është zgjidhur kontrata sipas nenit 22, nuk mund të lidhë kontratë të re me Fondin me një subjekt tjetër farmaceutik deri në përfundim të penaltetit të subjektit farmaceutik të cilit i është zgjidhur kontrata.

Ky aneks firmoset nga:

Për DREJTORINË RAJONALE TË FONDIT _____ /DEGA E FONDIT

..... Emri, Mbiemri dhe firma e Drejtorit të DRF/DF

Për Farmacinë _____

..... Emri, Mbiemri dhe firma e Personit fizik/ortak i
vetëm/administrator/përfaqësues ligjor

..... Emri, Mbiemri dhe firma e drejtuesit teknik

Aneksi 2 Dokumentacioni teknik i farmacisë

I. Fletëdalja e Importuesit/Shpërndarësit Farmaceutik

1.Kjo fletë dalje lëshohet nga Importuesi/Shpërndarësi Farmaceutik që ka kontratë me sigurimet shëndetësore. Fletëdalja e Importuesit/Shpërndarësit Farmaceutik duhet të jetë kompjuterike me faturën kompjuterike, sipas formatit dhe kërkesave të ligjit nr. 87/2019, “Për faturat dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar

2.Monedha e përdorur duhet të jetë vetëm leku shqiptar. Sasitë e barnave në fletë dalje të jenë sipas njësive që i përkasin listës së rimbursimit (ovule, flakon, tablet, ampule, capsule, pena, kuti (për fishat) etj..) ose njësi për ambalazh.

IV. Recetat

1. Receta me rimbursim të gjeneruara nga mjeku dhe receta me rimbursim të pranuar nga farmacia sipas programit e-Rx të miratuar nga FONDI.
2. Recetat pa rimbursim për barnat e Listës së barnave që rimbursohen (që plotësojnë elementet e domosdoshëm: emër/mbiemër pacienti, vulë personale të mjekut, nr. regjistri/vizitë shtëpie urgjencë, data e lëshimit).

V. Listë treguesit

1. Listë treguesit e recetave tip të miratuara nga FONDI.
2. Listë treguesit bëhen në dy kopje ku njëra dorëzohet në Drejtorinë Rajonale dhe tjetra qëndron në Farmaci.
3. Listë treguesit e faturave hyrje sipas programit të FONDI-t.

VI. Inventari

Fletë inventari sipas programit informatik tip të miratuara nga FONDI, i plotësuar sipas kërkesave përkatëse.